



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 568/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-69122-05-15-2018, me objekt: “Lyerje e ambjenteve të Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018”, me fond limit 3.642.312 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Gentian Horieti” p.f, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.”

Ankimues:

“Erges Mat” sh.p.k
Rr. “Vaçe Zela”, Nd.40, Shk.1, Ap.2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë
Rruga: “Jeronim De Rada”, Konvikti i Ekonomikut, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë

17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.05.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-69122-05-15-2018, me objekt: “Lyerje e ambjenteve të Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018”, me fond limit 3.642.312 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë.

II.2. Në datën 01.06.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|------------------------------|
| 1. “Erges Mat” sh.p.k | 2.028.420 lekë, skualifikuar |
| 2. “Doksani-G” sh.p.k | 2.070.724 lekë, skualifikuar |
| 3. “Meni” sh.p.k | 2.106.086 lekë, skualifikuar |
| 4. “Hysi-2F” sh.p.k | 2.221.152 lekë, skualifikuar |

5. “Cara” sh.p.k	2.357.180 lekë, skualifikuar
6. “Theos” sh.p.k	2.503.984 lekë, skualifikuar
7. “Altec” sh.p.k	2.592.660 lekë, skualifikuar
8. “2N” sh.p.k	2.620.750 lekë, skualifikuar
9. “Deutschcolor” sh.p.k	2.770.686 lekë, skualifikuar
10. “Tea-D” sh.p.k	2.804.560 lekë, skualifikuar
11. “O.B.Konstruksion” sh.p.k	2.805.150 lekë, skualifikuar
12. “2Z Konstruksion” sh.p.k	2.983.320 lekë, skualifikuar
13. “Gentian Horieti” sh.p.k	3.476.346 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentin:

“Operatori ekonomik “Erges Mat” ka paraqitur katalogun e bojrave deluxe dhe specififikimet teknike te ketyre bojrave por nuk ka paraqitur raportet e testimi nga laboratore te certifikuar ku të vërtetohet se specififikimet teknike të bojrave permbushin specififikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5. Sqarojmë se në pikën 1 te Ligjit 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, citohet sa me poshte: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e percaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.3. Në datën 06.06.2018 operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...]”

Ju keni pretenduar se: Operatori ekonomik “Erges Mat” ka paraqitur katalogun e bojrave deluxe dhe specififikimet teknike te ketyre bojrave por nuk ka paraqitur raportet e testimi nga laboratore te certifikuar ku të vërtetohet se specififikimet teknike të bojrave permbushin specififikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5. Sqarojmë se në pikën 1 te Ligjit 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, citohet sa me poshte: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga shqyrtimi i kësaj oferte

në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

Pretendimi juaj sa më lart nuk qëndron, është i kundraligjshëm, arbitrar, absolutisht i pavlefshëm dhe i pabazuar për faktin se:

Përsa i takon bojrave që do të përdorë shoqëria “Erges Mat” sh.p.k për realizimin e shërbimit të kërkuar, ka paraqitur katalogët, specifikimet teknike, kontratën e furnizimit e lidhur me shoqërinë “Daylux” sh.p.k, e cila është një ndër shoqëritë më të mëdha që merret me prodhimin e bojrave për lyeje të jashtme dhe të brendshme.

Vlen të theksojmë se shoqëria “Daylux” sh.p.k ka deklaruar me anë të deklaratës së datës 21.05.2018 se për tenderin objekt i këtij ankimi do të furnizojë shoqërinë tonë me bojrat e kërkuara nga ana juaj, duke pranuar dhe firmosur specifikimet teknike të bojës.

Ju vëmë në dijeni se nga ana jonë është paraqitur për shoqërinë “Daylux” sh.p.k edhe Certifikimi ISO 9001:2015, ku kjo shoqëri, sipas kësaj certifikate “Projektim, zhvillim, prodhim dhe shpërndarje të bojrave dhe verniqeve-mbështetje teknike bojrave dhe verniqeve” është certifikuar TUV Austria Group, i cili ndër të tjera pasqyron faktin që shoqëria “Daylux” sh.p.k është subjekt i rregullt mbikqyrje. Kjo vërteton më së miri garancinë e specifikimeve teknike të kërkuara nga ana juaj sipas pasqyrës së bashkëngjitur në dokumentat e tenderit. Po kështu ne kemi paraqitur dhe skedën për testimin e bojës së bërë nga vetë shoqëria “Daylux” sh.p.k me anë të së cilës është testuar boja, pasi kjo shoqëri është e certifikuar nga organizma ndërkombëtare austriake si për prodhimin ashtu edhe testimin e bojës.

Ndodhur përpara këtyre fakteve të cituara, pretendimet e autoritetit kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, janë arbitrare, të pabazuara në ligj dhe në dokumentacionin e paraqitur nga ana jonë.”

II.4. Njëpërmjet shkresës nr. 377 prot., datë 08.06.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si vijon:

“[...] Autoriteti kontraktor, në kriteret e vecanta të kualifikimit ka kërkuar që, meqënëse ambientet që do të lyhen, janë ambiente të frekuentuara nga nxënës të shkollave të mesme, boja që do të përdoret të jetë sa më cilësore dhe me parametra optimal. Për këtë qëllim është kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik dhe dokumentacion specifik për bojën që do të përdoret nga operatorët ekonomikë gjatë procesit të lyerjes.

Referuar sa më sipër, në kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.5. është kërkuar specifikisht që:

“Operatori ekonomik për bojrat që do të përdorë për realizimin e shërbimit të kërkuar duhet të paraqesë katalogët, skedat teknike, si dhe raportet e testimit nga laboratorë të certifikuar ku të vertetohet se specifikimet teknike të bojrave permbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 8 me qëllim përmbushjen e standarteve teknike të procesit”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e raporteve të testimit nga laboratorë të certifikuar për bojrat që do të përdoren për realizimin e shërbimit është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Autoriteti kontraktor, duke qënë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se për realizimin e shërbimit do të përdoren bojra cilësore rrjedhimisht i ka kërkuar operatorëve ekonomikë dokumentacion lidhur meraportet e testeve zyrtare. Ju pretendoni se e keni përmbushur këtë kriter kualifikues, pasi keni paraqitur këto dokumenta si më poshtë:

- 1. Në folderin me emërtimin “Kataloge_Daylux0001 (1)” ndodhen këto dokumenta:
 - a. Katalogu i bojës plastike të markës “Gold Eco Plast” të firmës prodhuese Daylux.**
- 2. Në folderin me emërtimin “Kataloge_Daylux0001” ndodhen këto dokumenta:
 - a. Foto të markave “Super lac enamel paint”, “Over lac”, “Golden Eco Plast”, “Super Eco Plast” dhe “Platin” pa asnjë të dhënë apo specifikim teknik.**
- 3. Në folderin me emërtimin “Skeda teknike”, ndodhen këto dokumenta:
 - a. Skeda teknike e astarit plastik të markës “Emulsion Primer”, të firmës prodhuese “Daylux”.*
 - b. Skeda teknike e bojës plastike të markës “Super Eco Plast”, të firmës prodhuese “Daylux”.*
 - c. Skeda teknike e bojës plastike të markës “Golden Eco Plast”, të firmës prodhuese “Daylux”.**
- 4. Në folderin me emërtimin “Skeda_raport bojës Daylux” ndodhen këto dokumenta:
 - a. Një dokument në gjuhë të huaj për të cilin ju pretendoni se është raport testimi për bojën plastike të markës “Golden Eco Plast” (mban datën 03.06.2016).**

Pra nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit teknik që ju keni paraqitur, u konstatua se ju keni dorëzuar skede teknike dhe katalog vetëm për artikullin “Bojë hidroplastike”, ndërkohë që raporti i testimit nga laborator i certifikuar, që në këtë rast është hartuar nga shoqëria prodhuese “Daylux”, i pretenduar në ankesë nga ana juaj, është në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën shqipe sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit, cka përbën shkak për skualifikim. Gjithashtu referuar preventivit dhe specifikimeve teknike si dhe termave të referencës, përvec lyerjes me bojë hodroplastike ka dhe lyerje me bojë zmalto për të cilën nuk keni paraqitur as katalog dhe as skede teknike, duke mosplotësuar kërkesën për kualifikim.

KSHA gjykon se ky kriter nuk është përmbushur nga operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k [...]”.

II.5. Në datën 13.06.2018 operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Gentian Horieti” p.f, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6. Në datën 25.06.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1109/2prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 393 prot., datë 25.06.2018, me objekt: “Dërgim informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Lyerje e ambienteve të Konvikteve të

Shkollave të Mesme për vitin 2018”, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k se: “nuk ka paraqitur raportet e testimit nga laboratore te certifikuar ku të vërtetohet se specifikimet teknike të bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 « Kriteret e vecanta të kualifikimit », «Kapaciteti teknik», pikat 2.3.5, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

2.3.5 “Operatori ekonomik për bojrat që do të përdorë për realizimin e shërbimit të kërkuar duhet të paraqesë katalogët, skedat teknike, si dhe raportet e testimit nga laboratorë të certifikuar ku të vërtetohet se specifikimet teknike të bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 8 me qëllim përmbushjen e standarteve teknike të procesit”.

Në shtojcën 1”Formulari i ofertës ekonomike”, të dokumentave të tenderit është përcaktuar plotësimi i tabelës si vijon:

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i Shërbimeve</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi /Njësi</i>	<i>Çmimi Total</i>	<i>Afati</i>
<i>1.</i>	<i>Lyerje me boje hidroplastike</i>	<i>19438 m²</i>			
<i>2.</i>	<i>Sherbetisje e bojatisje me gelqere</i>	<i>3000 m²</i>			
<i>3</i>	<i>Lyerje me boje vaji mbi sipërfaqe të patinuar</i>	<i>860 m²</i>			
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Ndërsa në shtojcën 11 “Termat e referencës” është parashikuar:

“Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Te realizohet lyerja e ambjenteve të brendshme të katër Konvikteve të Shkollave të Mesme “Konvikti i Hoteleri Turizëm”, “Konvikti i Ekonomikut”, “Konvikti i Mjeshtrisë Sportive”, “Konvikti Elektrik”.

Boje hidroplastike

Boja plastike të jetë ekologjike, pa erë që nuk ndikon në përhapjen e zjarrit, të përdoret për ambjente të brendshme dhe të jashtme. Përbërja e saj duhet të jetë me baze rezine akrilike dhe vinilike dhe në shpërndarje ujore i jep asaj rezistence optimale ndaj agjenteve të jashtëm. Formula e saj nuk dëmton përdoruesin dhe të jetë e përshtatshme për suva, tulle, gips, beton etj. Të ketë aftësi të mira mbuluese.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

- *Natyra e lidhësit: Kopolimer(rezinë) akriliku*
- *Rezistenca ndaj larjes: me shume se 20000 goditje furce*
- *Tharja : Ne te prekur 2-4 ore*
- *Mbulimi : >8 Mq / Liter me dy duar*
- *Hollimi: 5-20% me ujë*
- *Pesha specifike : 1 Liter=1,200 ± 10% Kg*
- *Pamja estetike : E lemuar, me shkelqim*
- *Ngjyrat ne dispozicion : E bardhe ose te ndryshme sipas katalogut*
- *Magazinimi : Ne temperatura ne intervalin + 5°C - 30°C*
- *Jetegjatesia : jo më pak se 2 (dy) vjet*
- *Paketimi : Ne konfeksion 5-15 Liter*

STANDARTET QE PERMBUSH:

- *ISO 11998 ose ekuivalentin, lidhur me rezistencen ndaj ferkimit.*
- *ISO 6504-3 ose ekuivalentin, lidhur me aftesine mbuluese, ku fuqia mbuluese te jete e “KLASES 2”.*
- *ISO 16000-9 ose ekuivalentin, lidhur me emetimin e komponenteve organike te paqendrueshem (VOC), ku emetimi te jete KLASES “A+”, si dhe T.V.O.C<1000µg/m³*

HIDROMAT

Boja eshte me baze rezine vinilike, e cila sherben per përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. Të ketë mbulim të mire dhe aplikim të lehtë.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

- *Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezine) vinili*
- *Viskoziteti : 32000 ±1800 cPs ne 30°C*
- *Tharja : 3-6 ore*
- *Mbulimi : >10Mq / Liter*
- *Pesha specifike : 1 Liter=1,6 ± 10%Kg*
- *Pamja estetike : Mat, pa shkelqim*
- *Ngjyrat ne dispozicion : E bardhe si dhe ngjyra te ndryshme sipas katalogut*
- *Magazinimi : Ne temperatura ne intervalin + 5°C - +30°C*

- *Jetegjatesia: jo më pak 2 vjet*
- *Paketimi : Ne paketim 10-15 Liter*

STANDARTET QE PERMBUSH:

- *ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike te paqendrueshem (VOC), ku emetimi te jete jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C<1000µg/m³.*

ZMALTO

Boja të jetë smalto me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Të jetë e përshtashme për sipërfaqe metalike, druri dhe suvaje.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

- *Natyra e lidhësit: Rezine Alkide*
- *Tretesi: Perzierje idrokarburesh olifatike*
- *Tharja : 6-10 ore ne prekje*
- *Mbulimi : >10 Mq / Liter*
- *Hollimi 5-20% me tretës*
- *Pesha specifike : 1 Liter/ 1,2 ± 10% Kg*
- *Pamja estetike : me shkelqim*
- *Ngjyrat ne dispozicion : E bardhe ose te ndryshme sipas katalogut*
- *Magazinimi : Ne temperatura ne intervalin + 5⁰C - +30⁰C*
- *Paketimi : Ne konfeksion 0.75-5 Liter.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “Erges Mat” sh.p.k, konstatohet se ofertën e tij mungojnë raportet e testimit nga laboratore te certifikuar për bojrat e kërkuara për lyerjen e ambienteve të konvikteve të shkollave të mesme.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike,

financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit me Nr. Ref-69122-05-15-2018, me objekt: “Lyerje e ambienteve të Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018”, me fond limit 3.642.312 lekë pa tvsh, është vendosur kushti që operatori ekonomik duhet të paraqesë (katalogët, skedat teknike) raportet e testimet nga laboratorë të certifikuar për bojrat që do të përdorë për realizimin e shërbimit të kërkuar, kërkesë e cila përbën detyrim ligjor për tu plotësuar nga ofertuesit e kualifikuar. Në rastin konkret rezulton se operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k, nuk ka paraqitur asnjë dokument lidhur me raportet e testimet nga laboratorë të certifikuar sic është parashikuar në kriteret kualifikuese të dokumentave të tenderit.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me këtë kërkesë, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues, do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuara nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k përsa i përket kualifikimit të padrejtë të shoqërisë “Gentian Horieti” p.f, nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i

drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseksi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k. mbetet i skualifikuar në bazë të arsytimit të KPP-së si më sipër cituar (pika III.1. e arsytimit), pra trajtimi i pretendimit të tij në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseksi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe këto pretendime nuk do merren në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erges Mat” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-69122-05-15-2018, me objekt: “*Lyerje e ambjenteve të Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018*”, me fond limit 3.642.312 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1109 Protokoli,

Datë 13.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha